

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVË
POLICE - POLICIA E KOSOVË
ARHIVA - ARCHIV
23-05-2024
Nr./Br. 860 / 2024
PRISHTINË - PRISTINA
DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLICISË
GENERALNI DIREKTOR POLICIJE
GENERAL DIRECTOR OF POLICE
Nr./Br./No. 01/0500
Data/Datum/Date 23.05.2024
PRISHTINË - PRISTINA - PRISHTINË

OFFICIAL



British Embassy
Pristina

23 Maj, 2024
Prishtinë

Memorandum Mirëkuptimi

Ndërmjet:

Këshillit Prokurorial të Kosovës, Policisë së Kosovës dhe
Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut
përfaqësuar nga Ambasada Britanike

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Policia e Kosovës (PK), dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut e përfaqësuar nga Ambasada Britanike, "Palët",

Duke pasur parasysh rëndësinë e rritjes së kualitetit të hetimeve, si dhe ngritjen e kapaciteteve hetimore,

Hynë në marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1 Qëllimi

1. Palët pajtohen të bashkëpunojnë për të mbështetur punën e Departamentit të sapoformuar për Inteligjencë dhe Analizë, në kuadër të Policisë së Kosovës, dhe Prokurorisë Speciale në luftimin e krimit të organizuar.
2. Projekti do të mbështesë Këshillin Prokurorial në hartimin aktitn nënligjor, që do të mundësojë themelimin e ekipeve të përbashkëta hetimore multidisiplinare sipas Nenit 17 të Ligjit për Prokurorinë Speciale. Këto ekipe themelohen për të siguruar hetim dhe ndjekje më efektive të veprave penale komplekse, të cilat janë në kompetencën e Prokurorisë Speciale të Kosovës (PSRK).
3. Ky Memorandum Mirëkuptimi synon të përcaktojë parimet e përgjithshme të bashkëpunimit në fushën e hetimit dhe ndjekjes penale të suksesshme të veprave penale të rëndësishme dhe sfiduese. Me synim që të mbështeten përpjekjet e përbashkëta për të përmirësuar cilësinë e hetimeve brenda PSRK-së dhe efektivitetin operacional të Departamentit për Inteligjencë dhe Analizë. Ky bashkëpunim realizohet përmes mbështetjes programatike si pjesë e projektit "Ngritja e kapaciteteve policore dhe hetimore kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda", Numri i referencës: CPG/7654/2022, financuar nga Ambasada Britanike dhe zbatuar nga SCJS Consultant.

4. Bashkëpunimi ndërmjet palëve do të përfshijë, por pa u kufizuar në, identifikimin e nevojave të PSRK-së dhe Departamentit të Inteligjencës dhe Analizës të Policisë së Kosovës, mbështetjen për procesin e hartimit të akteve nënligjore si dhe procedurat standarde të funksionimit gjatë gjithë fazës së hetimit, hartimin e planin e veprimit dhe strategjinë e hetimit për hetimin e suksesshëm të krimeve komplekse.
5. Palët do të ofrojnë mbështetje dhe bashkëpunim për njëra-tjetrën në përmbushjen e qëllimeve dhe obligimeve të përcaktuara në këtë Memorandum dhe Kornizën e Rezultateve të bashkangjitur, në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore që rregullojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e PSRK-së dhe PK-së në fushën e hetimit dhe ndjekjes penale, si dhe në forcimin dhe avancimin e kapaciteteve të stafit të këtyre institucioneve.

Neni 2

Detyrimet për KPK-në dhe PK-në

1. Bashkëpunimi i Përgjithshëm: KPK-ja dhe PK-ja bien dakord të ofrojnë qasje të plotë dhe bashkëpunim për projektin e financuar nga Ambasada Britanike, duke iu përmbajtur detyrimeve dhe përgjegjësi të tyre ligjore.
2. Përgjegjësitë specifike të KPK-së:
 - 2.1. Zhvillimi i një procesi të drejtë dhe transparent për hartimin dhe miratimin e aktit nënligjor për të lehtësuar formimin e ekipeve të përbashkëta hetimore, siç parashihet me legjislacionin përkatës;
 - 2.2. Zbatim i rekomandimeve nga partneri zbatues gjatë gjithë projektit;
 - 2.3. Sigurimi i pjesëmarrjes aktive dhe disponueshmërisë së zyrtarëve të caktuar në hartimin e legjislacionit sekondar dhe trajnimet përkatëse të organizuara nga Partneri Zbatues;
 - 2.4. Bashkëpunim me partnerin zbatues për të hartuar një plan pune të detajuar dhe plan veprimi për hartimin e aktit nënligjor dhe adresimin e çdo rekomandimi;
 - 2.5. Sigurimin e hapësirës dhe lehtësirave të nevojshme për aktivitetet e projektit.
3. Përgjegjësitë specifike të PK-së:
 - 3.1. Të marrë pjesë aktive në hartimin e aktit nënligjor për ngritjen e ekipeve të përbashkëta hetimore;
 - 3.2. Të lejojë qasjen e nevojshme të partnerit zbatues për të kryer një vlerësim të detajuar të nevojave për trajnim në lidhje me hetimin e veprave penale komplekse;

- 3.3.Zbatimi i rekomandimeve të partnerit zbatues gjatë gjithë projektit;
- 3.4.Sigurimi i pjesëmarrjes aktive dhe disponueshmërisë së zyrtarëve të caktuar në hartimin e legjislacionit sekondar dhe trajnimet përkatëse të organizuara nga Partneri Zbatues;
- 3.5.Bashkëpunimi me partnerin zbatues për të hartuar një plan pune të detajuar dhe plan veprimi për aktin nënligjor dhe adresimin e rekomandimeve;
- 3.6.Sigurimi i hapësirës dhe lehtësive të nevojshme për aktivitetet e projektit.

Neni 3 **Detyrimet e Projektit të Mbështetur nga Ambasada Britanike**

1. Përgjegjësitë e projektit:
 - 1.1.Të ofrojë bashkëpunim dhe ndihmë për Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe Policinë e Kosovës (PK) siç përcaktohet në nenin 1, paragrafi 3 të këtij Memorandumi, duke shfrytëzuar ekspertizën, përvojën dhe burimet njerëzore në dispozicion;
 - 1.2. Brenda një kohe të përshtatshme, sa më shume që të jetë e mundur, mbështetë KPK-në dhe PK-në për të adresuar nevojat e tyre specifike;
 - 1.3.Kryerja e vlerësimeve të plota të nevojave dhe çështjeve të tjera të përshkruara në këtë Memorandum dhe dhënia e rekomandimeve të nevojshme;
 - 1.4.Angazhimi për të nxitur bashkëpunimin me palët përkatëse të përfshira në fushën e hetimit dhe ndjekjes penale, përfshirë ato që konsiderohen të rëndësishme për përfshirje në ekipet e përbashkëta të hetimit.

Neni 4 **Mënyra e Bashkëpunimit**

Palët do të emërojnë personat përgjegjës për lehtësimin e zbatimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Neni 5 **Përfundimi**

1. Secila nga Palët mund të ndërpresë pjesëmarrjen e saj në këtë Marrëveshje duke i lëshuar një njoftim me shkrim një-mujor palës tjetër, në rrethanat e mëposhtme:

1.1. Dështimi në zbatimin e këtij Memorandumi dhe Kornizës së Rezultateve si dokument i bashkangjitur;

1.2. Mungesa e fondeve për të vazhduar mbështetjen e këtij projekti;

1.3. Një dështim i konsiderueshëm nga palët për të përmbushur ndonjë nga angazhimet e theksuara në këtë memorandum.

1.4. Forca Madhore.

1.5. Kur ndodhin ndryshime të cilat, sipas mendimit të Palëve, dëmtojnë ndjeshëm vlerën e kontributit të projektit drejt qëllimit të synuar.

Neni 6

Kopjet e memorandumit

Memorandumi do të nënshkruhet në tri (3) kopje identike, një (1) kopje për secilën palë në të dyja gjuhët (Shqip dhe Anglisht).


Neni 7

Dispozitat përfundimtare

1. Ky Memorandum do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e tij nga Palët dhe do të jetë në fuqi deri në mars 2025, kur përfundon projekti i mbështetur nga Ambasada Britanike.
2. Memorandumi i Mirëkuptimit mund të plotësohet ose ndryshohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve.
3. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me zbatimin e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit do të zgjidhet ndërmjet palëve përmes negociatave dhe marrëveshjeve shtesë.
4. Gjuha e Punës: Palët pranojnë dhe bien dakord që gjuha e punës për të gjitha qëllimet që lidhen me këtë memorandum është anglishtja.
5. Gjuha mbizotëruese: Në rast të ndonjë mospërputhjeje ose mosmarrëveshjeje që lind nga interpretimi i këtij memorandum, versioni në anglisht do të ketë përparësi.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e autorizuar të palëve do të vendosin nënshkrimet e tyre më poshtë:

Për Këshillin Prokurorial të Kosovës



Ardian HAJDARAJ

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Për Policinë e Kosovës



Gazmend HOXHA

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës

Për Ambasadën Britanike



Jonathan HARGRAVES

Ambasadori i Madhërisë së Tij

Licencat e avancuara te prokuuara, dorezuara dhe përdorura.	Nje version historik i baze eshte ne perdorim per koha te gjate. DIA duhet te përdoret Bazën e saj për t'i lejuar ata të jenë në gjendje të gurmojnë dhe të bëjnë vlerësime në të mira	Deri në gusht, DIA dhe projekti të identifikojnë nevojën për licenca që do të avancimin më së miri i baze për t'i lejuar ata të bëjnë një analizë më të mirë	Rritja e kapaciteteve në ofrimin e analizave më të mira të inteligjencës për rastet KRO.	E planifikuar		Burimi					
				E arritur		Burimi					
				Treguesi i produktit 4.3		Etapa 1		Etapa 2		Etapa 3	
				E planifikuar		Burimi		Burimi		Objektivi (data)	
si i realizimit të planit		HMG (€)		HMG SHARE (%)							

KPK-se duke ofruar vleresime/analiza te ekspertive ne regjloret e cila percakton se si krijohen ekipet e përbashkëta helimore.	Hartohet dhe miratohet rregulloret qe percakton se si krijohen EPH-te	Ligji i PSRK-se e detyron KPK-ne te hartojë aktin nenligjor i cili me tej percakton themelimin e EPH-se sipas nenit 17 te kety ligji.	Den ne fund te majit 2024 krijohet Grupi Punes per EPH	Den ne korrik 2024, KPK mbashletet nga ekspertet vendor dhe nga Britania e Madhe per te marrë pjesë ne grupet e saj te punës dhe për të dhënë vleresime dhe rekomandime.	Den ne gusht 2024, KPK mbashletet ne përfundimin e draftit të EPH me komentet e marra nga publiku, OSHC-te, partnerët e tjere ndërkombetare dhe rekomandimet e dhena nga projekti	Den ne shtator 2024, KPK miraton Rregulloren e EPH duke parasysh qasjen e rekomanduar te projektit si dhe ne perputhje me partnerët e tjere ndërkombetare	E planifikuar		Burimi					
							E arritur		Burimi					
							Treguesi i produktit 5.1		Etapa 1		Etapa 2		Etapa 3	
							E planifikuar		Burimi		Burimi		Objektivi (data)	
si i realizimit të planit		HMG (€)		HMG SHARE (%)										

e PSRK-se duke ofruar keshillia te ekspertive per i-sa (PSV-te e hartuara, trajnimi i ofruar, kriteret per n e rasteve, verifikimi i baze per ato pjese te EPH)	PSV-te e miratuara, trajnimi i ofruar, kriteret per pergjedhjen e rasteve te miratuara	EPH eshte nje koncept i n. Nuk ekziston PSV	Nuk priten zhvillime derisa KPK te miratoje Rregulloren e EPH	Den ne tetor 2024, KPK-ja dhe/ose PSRK-ja mbashletet ne vleresimin nese duhet te ketë ndonje PSV.	Nga dhjetori 2024 PSRK/KPK do te mbashletet ne hartimin e qdo PSV-je perkatese te kerkuar	E planifikuar		Burimi					
						E arritur		Burimi					
						Treguesi i produktit 6.1		Etapa 1		Etapa 2		Etapa 3	
						E planifikuar		Burimi		Burimi		Objektivi (data)	
e PSRK-se duke ofruar funksione te PSV-ve se si duhet te funksionojë një EPH në praktikë.	Treguesi i produktit 6.2	Nuk ka pasur asnjë shembull të mëparshëm kur një rast është përzgjedhur dhe hetuar përmes një EPH nën udhëheqjen e Prokurorit të PSRK-së	Deri në dhjetor 2024, prokurorët e PSRK-së u ofrohen kriteret mbi të cilat rekomandohet të krijohet një EPH	Deri në mars 2025, PSRK-ja është në gjendje të zgjedhë një rast të KRO i cili do të kalonte përmes EPH-së themeluar	Deri në qershor 2025, një rast trajtohet nga një EPH i themeluar	E planifikuar		Burimi					
						E arritur		Burimi					
						Treguesi i produktit 4.3		Etapa 1		Etapa 2		Etapa 3	
						E planifikuar		Burimi		Burimi		Objektivi (data)	
si i realizimit të planit		HMG (€)		HMG SHARE (%)									